

# ROLI I REVISTËS *EDUKATA ISLAME* NË KOMENTIMIN DHE INTERPRETIMIN E KUR'ANIT NË KOSOVË GJATË VITEVE 1971-1990

*THE ROLE OF EDUKATA ISLAME JOURNAL IN THE EXEGESIS AND INTERPRETATION OF THE QUR'AN IN KOSOVO DURING THE YEARS 1945–1990*

Valmire BATATINA KRASNIQI

Assist. Prof. Dr., Faculty of Islamic Studies – Pristina, Kosovo

 <https://orcid.org/0000-0001-8216-169X>

**Abstrakt:** Roli i Kur'anit në shoqëritë myslimane ka qenë gjithmonë qendror, jo vetëm si tekst fetar, por edhe si burim i dijes, kulturës dhe identitetit shpirtëror. Edhe në traditën shqiptare myslimane, Kur'ani ka zënë një vend të veçantë, duke ndikuar në jetën religjioze dhe intelektuale të besimtarëve ndër shekuj. Në këtë kuadër, një ndër aspektet më të rëndësishme të këtij ndikimi ka qenë zhvillimi i literaturës së tefsirit dhe përpjekjet për ta përcjellë kuptimin e Kur'anit në gjuhën shqipe. Ky studim shqyrton pikërisht këtë dimension, me fokus në Kosovë dhe rolin e revistës “Edukata Islame” gjatë periudhës 1971–1990. Duke analizuar përkthimet e Kur'anit, shkrimet akademike dhe qasjet metodologjike të paraqitura në këtë revistë, punimi synon të identifikojë përpjekjet kryesore të interpretimit kuranor në një kontekst të vështirë ideologjik dhe shoqëror. Nëpërmjet një ndarjeje kronologjike dhe analize përmbajtësore, studimi thekson rëndësinë historike e shpirtërore të kësaj reviste si një faktor kyç në ruajtjen e trashëgimisë islame dhe në formësimin e identitetit fetar e shoqëror në Kosovë. Rezultatet nënvizojnë nevojën për studime të mëtejshme mbi shtypin fetar shqiptar dhe rolin e tij në diskursin islam bashkëkohor.

**Fjalët kyçe:** Kosova, Tefsir, Kur'an, Komentim, *Edukata Islame*

**Abstract:** The role of the Qur'an in Muslim societies has always been central—not only as a religious text but also as a source of knowledge, culture, and spiritual identity. In the Albanian Muslim tradition as well, the Qur'an has held a special place, shaping the religious and intellectual life of believers across centuries. Within this framework, one of the most significant aspects of its influence has been the development of tafsir literature and the efforts to convey the meaning of the Qur'an in the Albanian language. This study explores precisely this dimension, with a focus on Kosovo and the role of the journal *Edukata Islame* during the period 1971–1990. By analyzing Qur'an translations, academic writings, and methodological approaches presented in this journal, the paper aims to identify key efforts in Qur'anic interpretation within a challenging ideological and social context. Through a chronological and content-based analysis, the study highlights the historical and spiritual significance of this journal as a key factor in preserving Islamic heritage and shaping religious and social identity in Kosovo. The findings emphasize the need for further research on the Albanian religious press and its role in contemporary Islamic discourse.

**Keywords:** Kosovo, Tafsir, Qur'an, Interpretation, *Edukata Islame*



**Corresponding author:** Valmire Batatina Krasniqi, [valosabat@hotmail.com](mailto:valosabat@hotmail.com)



**Citation:** Batatina Krasniqi, Valmire. “Roli i revistës Edukata Islame në komentimin dhe interpretimin e Kur'anit në Kosovë gjatë viteve 1971–1990.” In *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, edited by Sevba Abdula, Ahmet Koroğlu, and Fatih Şabani, 103–118. Skopje: IDEFE Publications, 2025. <https://doi.org/10.51331/EB11VBK>.

## Hyrje

Kur'ani Famëlartë është shpallur si mëshirë dhe udhëzim hyjnor për mbarë njerëzimin, duke përcjurar mesazhe universale që tejkalojnë përkatësitë etnike, gjuhësore dhe gjeografike. Duke marrë parasysh faktin se jo të gjithë besimtarët myslimanë e zotërojnë gjuhën arabe – gjuhën në të cilën është shpallur Kur'ani – dhe se edhe njerëz nga besime të tjera shfaqin interes për të kuptuar përmbajtjen dhe thelbin e tij, përkthimi i tekstit kuranor dhe interpretimi i tij në gjuhë të ndryshme është bërë domosdoshmëri dhe një veprim i arsyetuar, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kulturor dhe edukativ.

Tradita e përkthimit dhe komentimit të Kur'anit është kultivuar dhe trashëguar brez pas brezi nga dijetarët myslimanë, duke u konkretizuar në vepra të shumta, të cilat synonin ta bënin tekstin e shenjtë sa më të afërt dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë. Brenda këtij konteksti, edhe te shqiptarët u dëshmuar një përkushtim i veçantë ndaj fesë islame, jo vetëm në aspektin shpirtëror dhe praktik, por edhe në atë intelektual e shkencor. Një nga kontributet më të spikatura të tyre është padyshim ai në fushën e tefsirit dhe përkthimit të Kur'anit, ku studiues dhe intelektualë të shumtë shqiptarë kanë dhënë ndihmesa të çmuara. Hapat e parë në këtë drejtim u hodhën përmes përkthimeve të pjesëve të zgjedhura nga Kur'ani në gjuhën shqipe. Një nga figurat më të rëndësishme në këtë proces është Naim Frashëri – intelektual dhe poet i shquar i Rilindjes Kombëtare – i cili konsiderohet si pioner në përkthimin e teksteve kuranore në shqip. Në veprën e tij “Mësimet”, botuar në vitin 1894 në Bukuresht, ai përfshiu përmbledhjen “Thelb’ i Kur'anit”, ku përkthen dhe përpiket të përçojë përmbajtjen thelbësore të disa sureve dhe ajeteve kuranore.<sup>1</sup> Ky veprim jo vetëm që ka vlerë të jashtëzakonshme për historinë e tefsirit në gjuhën shqipe, por njëherësh paraqet një ndërthurje të përkushtimit fetar me idealin kombëtar dhe edukativ të kohës.

Ky përkthim i hershëm është dëshmi e qartë se te shqiptarët ekzistonte një vetëdije e thellë për rëndësinë e komunikimit të fjalës së Zotit në gjuhën amtare, si një mjet për përhapjen dhe kuptimin e fesë, por edhe për ngritjen e nivelit kulturor dhe arsimor të popullit. Kjo nismë u pasua më vonë nga një sërë dijetarësh dhe studiuesish të tjerë, të cilët kontribuan me përkthime të plota të Kur'anit si dhe me shpjegime të tij, duke ndërtuar kështu një trashëgimi të pasur në fushën e literaturës islame në gjuhën shqipe.

Duke ecur në vazhden e përpjekjeve për përkthimin dhe interpretimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, si dhe duke e vlerësuar rolin që kanë luajtur individë të

1 Nexhat Ibrahim, *Dimensione Kur'anore* (Shkup: Logos- A, 2003), 44.

veçantë në këtë proces, është e rëndësishme të ndalemi edhe te institucionet dhe platformat që kanë kontribuar në zhvillimin e mendimit islam dhe shkencor ndër shqiptarë. Një ndër format më efikase për përhapjen dhe zhvillimin e ideve, dijes dhe diskutimeve akademike janë botimet periodike – veçanërisht ato që përfshijnë analiza shkencore, fetare dhe kulturore. Botimet akademike dhe shkencore periodike nuk janë vetëm mjet informimi, por edhe instrumente të rëndësishme në procesin e transmetimit të ideve, mendimeve dhe arritjeve të studiuesve në fusha të ndryshme. Ato shërbejnë si urë lidhëse midis dijes së krijuar në kontekste të ndryshme dhe shoqërive që synojnë zhvillim dhe përparim intelektual. Për më tepër, përmes përkthimeve, këto revista mundësojnë qasjen në mendimin bashkëkohor ndërkombëtar dhe paraqitjen e tij në kontekstin lokal. Kësisoj, ato ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e vetëdijes kolektive dhe në thellimin e kuptimit të çështjeve fetare dhe shoqërore.

Edhe pse në kontekstin e Kosovës dhe më gjerë në trevat shqiptare të Ballkanit numri i revistave periodike me profil fetar-islam dhe shkencor nuk ka qenë i madh, një përjashtim të rëndësishëm përbën revista “Edukata Islame”, e cila filloi të botohet në vitin 1971 dhe vazhdon botimin edhe sot.<sup>2</sup> Ajo njihet si revista e parë islame-shkencore në Kosovë<sup>3</sup> me profil të qartë akademik dhe teologjik. Me një përmbajtje të pasur, revista ka pasur për qëllim jo vetëm të plotësojë nevojat e lexuesve myslimanë të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut,<sup>4</sup> por edhe të shërbejë si platformë për trajtimin e problemeve bashkëkohore të komunitetit islam shqiptar në një kornizë shkencore e kritike.

“Edukata Islame” ka ofruar një hapësirë të vlefshme për mendimtarët dhe studiuesit vendorë, duke nxitur krijimin e një tradite të mendimit të organizuar dhe të dokumentuar në formë të shkruar.<sup>5</sup> Ajo ka tubuar rreth vetes autorë të përkushtuar dhe ka shërbyer si tribunë për zhvillimin e kulturës dhe vetëdijes islame në hapësirën shqiptare. Përmes artikujve të saj, revista ka trajtuar tema të ndryshme në fushën e teologjisë, etikës (ahlak), jurisprudencës islame (fikih), besimit (akaid), historisë islame dhe natyrisht tefsirit – duke i dhënë kësaj të fundit një vend të veçantë ndër temat e trajtuara. Në këtë kuadër, fusha e tefsirit zë një peshë të veçantë në përmbajtjen e revistës. Shkrimet që analizojnë

2 Ramadan Shkodra, *Bibliografi e Revistës “Edukata Islame” (1971-2016)* (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2017), 13.

3 Feti Mehdiu, “Dy Jubile të Kulturës Islame Në Kosovë,” *Edukata Islame*, nr. (2017): 110.

4 Ramadan Shkodra dhe Aziz Pireva, “Historiku i publicistikës islame në gjuhën shqipe në Kosovë” *Dituria Islame*, nr. 101 (1998): 61.

5 Fation Shabani, “Kosova’da Yayınlanan İslami Bilimsel-Akademik Dergilerin İçeriği ve Kritiği”, *Balkan Araştırmaları Dergisi*, nr. 2 (2015): 42.

aspektet gjuhësore, kontekstuale, historike dhe shpirtërore të ajeteve kuranore janë publikuar rregullisht, duke dëshmuar interesin dhe nevojën për një qasje të thelluar ndaj kuptimeve të Kur'anit. Kjo dëshmon një vazhdimësi të natyrshme të përpjekjeve për përhapjen e mesazhit kuranor në gjuhën shqipe dhe për ta sjellë atë në një kuptim bashkëkohor, të ndërlidhur me realitetin social, kulturor dhe shpirtëror të besimtarëve.

Në vijim të këtij punimi, do të prezantohet një pasqyrë e përgjithshme e shkrimeve në fushën e tefsirit të publikuara në këtë revistë, me qëllim të evidencimit të zhvillimeve kryesore, tendencave metodologjike dhe autorëve kontribues që kanë ndikuar në formësimin e mendimit tefsiro-kuranor në trevat shqiptare përgjatë viteve 1971-1990.

## Edukata Islame: Roli dhe Rëndësia

Revista “Edukata Islame” përfaqëson botimin e parë periodik me karakter profesional, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë teknik, që iu ofrua në mënyrë të organizuar dhe institucionale lexuesit shqiptar në Kosovë dhe më gjerë në periudhën e Jugosllavisë socialiste. Ajo lindi si një vazhdimësi e revistës së mëparshme me titull “Buletini”, e cila ishte botuar me mjete të thjeshta teknike dhe pa standarde të mirëfillta editoriale. Në vendimin e saj themelues, Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës “Ilmije” theksonte se “Buletini”, megjithëse kishte shërbyer deri atëherë si një mjet komunikimi në gjuhën shqipe, nuk ishte më në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe nuk arrinte të përmbushte nevojat e komunitetit mysliman në rritje, sidomos në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes. Si rrjedhojë, më 2 shkurt 1971, ky Këshill mori vendimin për themelimin e një reviste të re, të quajtur “Edukata Islame”, e cila do të botohej në shtyp dhe do të kishte një nivel më të lartë profesional në të gjitha aspektet.<sup>6</sup>

Ky hap shënoi një moment të rëndësishëm për zhvillimin e diskursit islam në gjuhën shqipe, duke e vendosur revistën “Edukata Islame” si një platformë të re akademike dhe kulturore, ku do të shtjelloheshin tema të rëndësishme nga fusha e teologjisë islame, edukimit, moralit, historisë, tefsirit dhe çështjeve aktuale shoqërore, në përputhje me sfidat e kohës. Revista “Edukata Islame” ka një rëndësi shumëdimensionale, duke tejkaluar funksionin bazik të një organi informues fetar. Ajo nuk shërben vetëm si një burim i aksesueshëm për lexuesin shqipfolës që dëshiron të mësojë rreth Islamit në gjuhën amtare, por edhe si një hapësirë e çmuar akademike dhe kulturore ku intelektualët fetarë shqiptarë

<sup>6</sup> *Edukata Islame*, nr. 1/1 (1971): 56.

mund të artikulojnë idetë, qëndrimet dhe angazhimet e tyre shkencore në mënyrë të strukturuar dhe të përkushtuar.

Në thirrjen zyrtare për bashkëpunim të shpallur nga redaksia e revistës, theksohen tri karakteristika thelbësore që e përcaktojnë vizionin dhe funksionin e saj. *Së pari*, revista paraqitet si një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj kërkesave të kohës, në një periudhë kur myslimanët shqiptarë të ish-Jugosllavisë ndjenin mungesën e theksuar të literaturës fetare në gjuhën shqipe. *Së dyti*, për herë të parë u mundësohej besimtarëve shqiptarë që ta mësonin fenë islame në gjuhën e tyre amtare, duke krijuar kështu një lidhje më të natyrshme dhe më të thellë me përmbajtjen fetare. *Së treti*, për shkak të mungesës së një platforme të tillë në gjuhën shqipe, shumë hoxhallarë dhe autorë fetarë ishin të detyruar t'i botonin shkrimet e tyre në gjuhë të huaja, duke kufizuar në këtë mënyrë ndikimin dhe përfshirjen e lexuesve shqiptarë. Përmes themelimit të kësaj reviste, u hap një rrugë e re për zhvillimin dhe institucionalizimin e mendimit islam në gjuhën shqipe, duke u dhënë zë autorëve vendorë dhe duke shërbyer njëkohësisht si urë komunikimi mes traditës islame dhe realitetit shoqëror të shqiptarëve. Revista nuk ishte vetëm një produkt i domosdoshmërisë, por edhe një nismë strategjike për ruajtjen dhe promovimin e identitetit fetar dhe kulturor në kushte të ndërlikuara shoqërore e politike.<sup>7</sup>

Në përvjetorin e dhjetë të themelimit të revistës “Edukata Islame”, një nga bashkëthemeluesit dhe kontribuesit më të njohur të saj, i ndjeri Avni Aliu, vlerësoi në mënyrë të thellë rëndësinë dhe zhvillimin e saj ndër vite. Ai e përshkroi themelimin e revistës si realizimin e një ëndrre të dikurshme, që më në fund mori formë reale dhe tejkaloi pritshmëritë fillestare të themeluesve të saj. Sipas tij, “Edukata Islame” me kalimin e kohës nuk mbeti thjesht një nismë e vogël, por u zhvillua në përmbajtje dhe cilësi, duke u bërë një institucion i rëndësishëm në botën e publicistikës dhe mendimit islam shqip. Në reflektimet e tij, Aliu thekson disa veçori të dallueshme të kësaj reviste, të cilat përbëjnë bazën e identitetit të saj publik dhe intelektual.

*Së pari*, ai nënvizon faktin se “Edukata Islame” ishte revista e parë me fizionomi të mirëfilltë profesionale që botohej në gjuhën shqipe në fushën e dijes islame. Kjo ishte një arritje e veçantë për kohën, duke qenë se literatura islame në shqip ishte ende në fazat e hershme të zhvillimit dhe institucionalizimit. *Së dyti*, revista u pozicionua si një nismë pionere në trajtimin e çështjeve të ndryshme nga fushat e dijes islame – si tefsiri, akaidi, etika islame, jurisprudenca, historia, si dhe tema të tjera aktuale me karakter kulturor e shoqëror. Me këtë, ajo u bë një arenë

7 Sadat Islami, “Përkthime në revistën Edukata Islame,” *Edukata Islame*, nr. 127-128, (2022): 147.

ku u ndërthurën tradita dhe mendimi bashkëkohor islam në gjuhën shqipe. Së treti, Aliu e përshkruan “Edukatën Islame” si një përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj kërkesave intelektuale, kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve myslimanë, të cilët kishin nevojë për një platformë të tillë për t’u lidhur më thellë me fenë dhe identitetin e tyre në një kohë të sfiduar nga faktorë të shumtë shoqërorë e politikë.<sup>8</sup>

Këto vlerësime dëshmojnë qartë se revista *Edukata Islame* nuk ishte vetëm një produkt i përpjekjeve të një grupi të vogël dijetarësh, por një fenomen me ndikim të gjerë, që shërbeu si urë lidhëse ndërmjet dijes fetare dhe shoqërisë shqiptare, duke kontribuar në kultivimin e një tradite të qëndrueshme të mendimit islam në gjuhën shqipe.

Revista, për shkak të cilësisë së saj akademike dhe kulturore, përmban artikuj që në pjesën më të madhe i përmbushin kriteret shkencore dhe qëndron në një nivel më të lartë krahasuar me revista të tjera akademike të botuara në Kosovë. Megjithatë, disa nga artikujt vuajnë nga mungesa e referencave të plota në pjesën e bibliografisë, ndërsa në disa të tjera mungojnë fusnotat, që konsiderohen si mangësi të dukshme të revistës. Një problem tjetër i rëndësishëm është se asnjë artikull nuk përmban fjalë kyçe, si dhe mungesa e pjesëve hyrëse dhe përfundimtare në shumicën e tyre. Për më tepër, përdorimi i një stili të ngurtë dhe jo të rrjedhshëm në disa artikuj dëshmon se përmbajtja humbet nga aspekte të rëndësishme të qartësisë dhe akademiks, duke ndikuar negativisht në kredibilitetin shkencor të revistës.<sup>9</sup>

Këto mangësi mund të arsyetohen pjesërisht me rrethanat specifike dhe zhvillimet kohore në të cilat revista është botuar. Në një kontekst ku sistemi akademik dhe infrastruktura kërkimore në Kosovë janë ende në zhvillim e sipër, sfidat në lidhje me standardet dhe praktikën më të përparuara të botimit shkencor janë të pritshme. Njëkohësisht, mungesa e burimeve të mjaftueshme, mund të ndikojnë në cilësinë e artikujve. Për më tepër, periudha kohore dhe rrethanat sociale dhe kulturore shpesh ndikojnë në mënyrën e komunikimit akademik, ku disa norma dhe praktika ende janë në proces përafrimi me standardet ndërkombëtare. Kjo situatë kërkon përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve akademike dhe rritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e standardeve shkencore, në mënyrë që revista të mund të përmirësohet dhe të konsolidohet si një platformë me ndikim më të madh dhe me një cilësi më të lartë.

8 *Edukata Islame*, nr. X/30 (1981): 4.

9 Shabani, “Kosova’da Yayınlanan İslami Bilimsel-Akademik Dergilerin İçeriği ve Kritiği,” 43.

## Analizë e Temave Kur'anore në Artikujt e Revistës Edukata Islame Gjatë Periudhës 1971–1990

Për të krijuar hapësirë akademike për publikimin e kontributeve shkencore në fushën e studimeve kuranore, revista “Edukata Islame” ka themeluar një rubrikë të posaçme të titulluar “Rubrika e Tefsirit”.<sup>10</sup> Kjo rubrikë, që nga numrat e parë të revistës, ka shërbyer si një platformë për trajtimin dhe reflektimin shkencor mbi përmbajtjen e Kur’anit dhe metodologjinë e interpretimit të tij. Fillimisht, artikujt e botuar në këtë rubrikë kishin kryesisht karakter komentues, duke u fokusuar në interpretimin e ajeteve dhe sureve të veçanta të Kur’anit. Këto interpretime synonin t’u ofronin lexuesve kuptimin e drejtpërdrejtë të mesazheve kuranore në një gjuhë dhe stil të qasshëm për publikun shqipfolës. Me kalimin e kohës dhe rritjen e interesit akademik për studimet kuranore, përmbajtja e kësaj rubrike u pasurua me artikuj që trajtonin aspekte më të thella teorike dhe konceptuale të shkencës së tefsirit.

Ky zhvillim gradual tregon për një pjekuri metodologjike dhe për një përkushtim në rritje ndaj përpunimit të tematikave kuranore në mënyrë të sistematizuar dhe analitike. Nga kjo perspektivë, përmbajtja e kësaj rubrike mund të klasifikohet në dy kategori kryesore: *Interpretime të pjesshme të Kur’anit* – që përfshijnë komentimin e sureve dhe ajeteve të veçanta, duke synuar të ndriçojnë domethënien e tyre për kontekstin bashkëkohor dhe për nevojat e komunitetit; *Studime teorike dhe konceptuale në fushën e tefsirit* – të cilat filluan të botohen pas viteve 1990 dhe shqyrtonin çështje si metodologjia e interpretimit kuranor, qasjet tradicionale dhe bashkëkohore në tefsir, roli i kontekstit historik dhe gjuhësor në kuptimin e tekstit hyjnor, si dhe raportin ndërmjet tefsirit klasik dhe nevojave të reja të lexuesit modern. Përmes kësaj rubrike, “Edukata Islame” jo vetëm që ka ofruar një hapësirë të vlefshme për publikimin e dijes islame në gjuhën shqipe, por ka ndihmuar në institucionalizimin e studimeve kuranore si një fushë e veçantë brenda diskursit akademik shqiptar, duke nxitur diskutim, analizë dhe reflektim kritik në një frymë bashkëkohore dhe shkencore.

### Interpretime të pjesshme të Kur’anit në revistën “Edukata Islame”

Gjatë periudhës 1971–1990, revista “Edukata Islame” shërbeu si një ndër platformat më të rëndësishme për përhapjen e mendimit islam në Kosovë, në një kohë të karakterizuar nga sfida të shumta politike dhe ideologjike. Në këtë kontekst,

10 Shkodra, *Bibliografi e Revistës Edukata Islame (1971-2016)*, 14.

Sherif Ahmeti, si një nga figurat qendrore të mendimit islam në Kosovë dhe më gjerë në hapësirën shqiptare, dha një kontribut të veçantë përmes interpretimeve të tij të pjesshme të Kur'anit, të botuara në faqet e kësaj reviste. Këto interpretime nuk përfaqësojnë një koment të plotë të tekstit kur'anor, por një përzgjedhje të kujdesshme të ajeteve që trajtojnë çështje morale, edukative dhe shoqërore, në përputhje me nevojat e kohës dhe kufizimet ideologjike të sistemit. Në këtë drejtim, H. Sherif Ahmeti për më shumë se dy dekada mbajti mbi supë barrën kryesore në drejtimin, zhvillimin dhe institucionalizimin e publicistikës islame në gjuhën shqipe, përmes një veprimtarie të vazhdueshme dhe shumëdimensionale. Ndër kontributet më të rëndësishme të tij, pa dyshim radhiten mbi 30 artikuj në fushën e interpretimit të Kur'anit, të botuar në revistën shkencore "Edukata Islame".<sup>11</sup> Këto punime përfaqësojnë interpretime të pjesshme dhe tematike të ajeteve kur'anore, kryesisht nga sure të shkurtra, të cilat janë përzgjedhur dhe trajtuar në funksion të mesazhit edukativ, moral dhe shoqëror që përcjellin. Ky nënkapitull synon të analizojë përmbajtjen, metodologjinë dhe funksionin e këtyre interpretimeve, duke vendosur theksin te qasja hermeneutike e Ahmetit, përmes së cilës ai e interpreton tekstin kur'anor në lidhje të ngushtë me sfidat ideologjike dhe kontekstin socio-politik të viteve 1971–1990. Hermeneutika e tij dallon për theksin që i jep aspektit praktik të mesazhit kur'anor dhe përpjekjen për ta aktualizuar atë në rrethana konkrete, duke ruajtur gjithnjë një ekuilibër ndërmjet traditës fetare dhe realitetit bashkëkohor.

Nga analiza e publikimeve kurano-tefsirore të H. Sherif Ahmetit del qartë një stil i veçantë interpretimi, që dallohet për elegancë, qartësi dhe përmbajtje të qëndrueshme. Ai eviton qasjet polemizuese dhe shmang shpjegimet e stërzgajtura leksikore, duke zgjedhur në vend të tyre një mënyrë të përmbledhur dhe të sistematizuar të paraqitjes së informatave. Ahmeti e mban fokusin në thelbin tematik të ajetit apo kaptinës, duke u ndalur vetëm te aspektet që i konsideron të dobishme për edukimin dhe ndërgjegjësimin fetar të lexuesit. Kjo qasje metodologjike reflekton jo vetëm një ndjeshmëri gjuhësore, por edhe një vetëdije të thellë për kontekstin dhe audiencën shqiptare, e cila në pjesën më të madhe nuk kishte njohuri të mjaftueshme për gjuhën arabe. Për këtë arsye, në shumicën e rasteve Sherif Ahmeti bën transkriptimin e ajeteve kur'anore nga arabishtja në alfabetin latin, duke e shoqëruar atë me përkthimin në gjuhën shqipe dhe pastaj me një koment të shkurtër, por tematikisht të ngjeshur dhe metodologjikisht të orientuar. Ai gjithashtu i kushton vëmendje kontekstit të shpalljes së ajeteve

11 Batatina Valmire Krasniqi, "Kosova'da Tefsir Alanında Yapılan Çalışmalar Üzerine Genel Bir Bakış", nr. 11, *Rumeli İslam Araştırmaları Dergisi*, Trakya Üniversitesi, (2023), 40.

(esbabu'n-nuzul), duke nxjerrë prej tyre mësimë morale dhe vlëra universale që ruajnë aktualitetin e tyre në çdo kohë.

Ajo që e bën të dallueshëm komentin e Sherif Ahmetit është aftësia e tij për ta zbrërthyer mesazhin kur'anor me një gjuhë të qartë e të kuptueshme, duke ruajtur njëkohësisht thellësinë dhe dinjitetin e tekstit hyjnor. Me mjeshtëri ai arrin ta paraqesë madhështinë dhe mrekullinë e Kur'anit në mënyrë që ajo të komunikohet me ndjeshmëri të zemrat dhe ndërjegjet e lexuesve. Siç vë në dukje edhe studiuesi S. Bajgora në kumtesën e tij kushtuar kontributit të Ahmetit në fushën e tefsirit, një aspekt i veçantë i interpretimit të tij është përpjekja për të ndërlikuar mesazhin kur'anor me argumente akaidologjike dhe shkencore, duke krijuar një urë të natyrshme ndërmjet fesë dhe shkencës. Këtë e bën pa e tepruar në shpjegime teknike dhe pa cenuar aspak shenjtërinë e Kur'anit, çka tregon për një ekuilibër të qëlluar ndërmjet përmbajtjes teologjike dhe përqasjes bashkëkohore të interpretimit.<sup>12</sup> Sa për të ilustruar mendjemprehtësinë dhe afinitetin e madh të këtij dijetari do të sjellim disa komente origjinale, gjatë komentimit të tij të kaptinës "Zilzal". Në analizën e tij mbi këtë kaptinë, Ahmeti nuk përqendrohet në detajet e zbritjes (esbabu'n-nuzul) së saj dhe nuk përfshin transmetime rreth vlerës apo shkakut të zbritjes, siç është zakonisht praktika e komentuesve klasikë dhe bashkëkohorë të Kur'anit. Kjo qasje, me gjasë, është ndikuar nga karakteri i revistës shkencore ku është botuar puna e tij. Megjithatë, për secilin ajet të kësaj kaptine, ai ofron një koment të përmbledhur, zakonisht prej 10–15 rreshtash, pas së cilës ai kalon në një analizë më të gjerë dhe të thelluar të qëllimeve të përgjithshme të kaptinës, ku shfaqet qartazi aftësia e tij interpretative. Pas hapjes së komentimit me besmelen, në analizën e ajetit të parë të kaptinës, Ahmeti thekson: "1. Kur të dridhet toka me atë dridhjen e saj". E kur do të vjen koha e të bëjë toka atë dridhje të saj të jashtëzakonshme, të fortë e të fyrihshme, dridhje që trondit zemrat në gjoksa dhe mendjet në koka. Atë dridhje toka e bën kur të vjen koha e shkatërrimit katastrofal të çdo qenie e sendi, kur të vjen koha e shkatërrimit të planetit tonë, tokës e edhe yjeve në qiej. E ai është momenti i ashtuquajtur kijamet".<sup>13</sup> Metoda e komentimit që Ahmeti ndjek është një interpretim i përmbledhur dhe konceptual, i cili synon të lidhë kuptimin e drejtpërdrejtë të ajetit me pasojat e tij eskatologjike, duke sjellë një reflektim të thellë mbi përmbajtjen shpirtërore dhe kozmologjike të ajetit.

12 Sabri Bajgora, *Kontributi i haxhi Sherifit në lëmin e Tefsirit dhe në përktimin e Kur'anit* (Prishtinë, 2016).

13 Ahmeti, *Edukata Islame*, nr. 41-42, 3.

Ahmeti dallohet për mënyrën e veçantë të interpretimit, duke përdorur shembuj praktikë dhe argumente logjike të nxjerra nga përvoja dhe jeta e përditshme, dhe duke i bërë komentet e tij të kuptueshme dhe të afërta për një audiencë të gjerë. Kjo qasje e bën punën e tij interpretuese jashtëzakonisht të popullarizuar dhe të kërkuar nga lexuesit e kohës, pasi përmbajtja bëhet më e qartë dhe më e lidhur me realitetin njerëzor. Zgjuarsia dhe mendjemprehtësia që karakterizojnë Ahmetin reflektohen në të gjitha komentet e tij, duke dëshmuar një thellësi dhe njohuri të madhe në interpretimin e Kur'anit.

Një shembull ilustrues i këtij stili është interpretimi i kaptinës “Kevther”, e cila përbëhet vetëm nga tre ajete. Ahmeti fillon komentimin duke trajtuar historikun e shpalljes së kaptinës, duke i shpjeguar shkaqet dhe rrethanat që çuan në zbritjen e saj. Ai përmend faktin e njohur historik se Muhamed a.s. u ballafaqua në fillimet e predikimit të tij me rezistencë të fortë, duke përfshirë tortura, intriga, dhe tallje nga pjesëtarë të popullit të tij, madje edhe nga të afërm të tij. Këto sulme dhe përpjekje për denigrim, të cilat synonin të dobësonin ndikimin e mesazhit të tij, konsiderohen shkak i zbritjes së kaptinës “Kevther”.<sup>14</sup> Ahmeti evidenton se disa nga kundërshtarët e peygamberit a.s., veçanërisht disa anëtarë të kurejshëve, përdorin akuzat dhe shpifjet për të diskredituar atë, duke përmendur mungesën e pasardhësve meshkuj si një argument kundër tij. Këto sulme synonin të ndikonin në opinionin publik për ta larguar atë dhe mesazhin që po përcillte. Në këtë kontekst, Ahmeti shpjegon se kaptina u zbrit si përgjigje hyjnore ndaj intrigave dhe fyerjeve të kundërshtarëve, dhe si mbështetje morale për Muhamedin a.s. Një tipar i rëndësishëm i metodës së komentimit të Ahmetit është se, megjithëse në disa raste ai trajton shkakun e zbritjes së ajetit apo kaptinës, si në rastin e “Kevther”, kjo nuk është e njëjtë për të gjitha komentet e tij. Ai ndjek një metodë të qëndrueshme, e cila përfshin komentimin e qartë dhe të kapshëm për lexuesin, duke kombinuar elemente historike, linguistike dhe përmbajtësore, dhe kështu krijon një tefsir që përmban karakteristika të veçanta, të cilat e bëjnë veprën e tij një burim të rëndësishëm për studimin akademik të Kur'anit.

### **Lista e publikimeve të Sherif Ahmetit në revistën “Edukata Islame”**

Sherif Ahmeti kontribuoi me një numër të konsiderueshëm artikujsh tefsirorë në revistën “Edukata Islame”, të cilat mund të ndahen në komentime të sureve të plota, interpretime të ajeteve të veçanta, si dhe përkthimi i kaptinave të gjata përmes një serie shkrimesh të ndërlidhura. Për një paraqitje më të plotë të tyre, shih Shtojcën 1.

<sup>14</sup> Ahmeti, *Edukata Islame*, nr: 15-16, 3.

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i Komentimit</b>	<b>Titulli / Ajeti / Sureja</b>	<b>Revista “Edukata Islame” (Viti/Numri)</b>
1	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures el-Fatiha</i>	<i>Edukata Islame, nr: 3, 1971, fq. 8-16</i>
2	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures vel-Asr</i>	<i>Edukata Islame, nr: 2, 1971, fq. 3-9.</i>
3	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures el-Ihlas</i>	<i>Edukata Islame, nr: 5, 1972, fq. 3-9.</i>
4	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures el-Felek</i>	<i>Edukata Islame, nr: 22, 1979, fq. 3-7.</i>
5	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures el-Kadër</i>	<i>Edukata Islame, nr: 27, 1980, fq. 13-19.</i>
6	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>Komentimi i Sures Zilzal</i>	<i>Edukata Islame, nr. 41-42, 1985, fq. 3-11</i>
7	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>“Kaptina el-Bekaretu”</i>	<i>Edukata Islame, nr: 41-42, 1985, fq. 60-63.</i>
8	<i>Komentim i Sureve të Plota</i>	<i>“Komentimi i Sures Kevther,</i>	<i>Edukata Islame, nr: 15-16, 1976, fq. 3-5.</i>
9	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>“Inned-dine indallāhi el-Islām”</i>	<i>Edukata Islame, nr: 4, 1972, fq. 3-8.</i>
10	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>“Rabbena atina fid-dunja haseneten...”</i>	<i>Edukata Islame, nr: 6, 1971, fq. 3-10.</i>
11	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>“Ve ma halektu el-xhinne vel-inse il-la li-ya‘budūn” (Dharijat, 56–58)</i>	<i>Edukata Islame, nr: 9-10, 1974, fq. 3-8.</i>
12	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>“O ju njerëz, Ne ju krijuam nga mashkull e femër...”</i>	<i>Edukata Islame, nr: 11-12, 1974, fq. 3-7.</i>
13	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>“Dhe fale namazin, se namazi largon nga imoraliteti...”</i>	<i>Edukata Islame, nr: 13, 1975, fq. 3-6.</i>

Nr.	Lloji i Komentimit	Titulli / Ajeti / Sureja	Revista "Edukata Islame" (Viti/Numri)
14	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Ja ejjuhel-ledhine amenu, kutibe alejkumus-sijam" (el-Bekare, 183)</i>	<i>Edukata Islame, nr: 14, 1975, fq. 7-10.</i>
15	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"O ju që keni besuar, kur të thirret për namaz të xhumasë..."</i>	<i>Edukata Islame, nr: 17, 1976, fq. 3-8.</i>
16	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"O Zoti ynë, dërgo ndër ata një të dërguar nga mesi i tyre..." (el-Bekare, 129)</i>	<i>Edukata Islame, nr: 18, 1976, fq. 3-7.</i>
17	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Elif Lam Mimë... në të nuk ka dyshim..." (el-Bekare, 1-4)</i>	<i>Edukata Islame, nr: 19, 1977, fq. 3-7.</i>
18	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>Ajetul Kursij</i>	<i>Edukata Islame, nr: 23, 1979, fq. 3-9.</i>
19	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Senurihim ajätinâ fi-l-âfâki ve fi enfusihim..."</i>	<i>Edukata Islame, nr: 24, 1979, fq. 3-8.</i>
20	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Inna 'aradna el-emanete..."</i>	<i>Edukata Islame, nr: 25, 1979, fq. 3-8.</i>
21	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Ve ma erselna min kablike min resulin..."</i>	<i>Edukata Islame, nr: 28-29, 1980, fq. 3-9.</i>
22	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Vallahu ahrexhekum min butuni ummehâtikum..."</i>	<i>Edukata Islame, nr: 44-45, 1986, fq. 3-8.</i>
23	<i>Komentim i Ajeteve të Veçanta</i>	<i>"Komentimi i një Ajeti Kuranor"</i>	<i>Edukata Islame, nr:44-45, 1986, fq. 3-9.</i>
24	<i>Përkthimi Kaptinave të Plota</i>	<i>Suratu Esh-Shu'ara (Kaptina XXVI) – Mekke, 227 ajete</i>	<i>Edukata Islame, nr: 31-32, 1981, fq. 10-18.</i>
25	<i>Përkthimi i Kaptinave të Plota</i>	<i>Suratu el-Bekare (Kaptina II) – Ajetet 1-25</i>	<i>Edukata Islame, nr: 35-36, 1982, fq. 57-60.</i>

Nr.	Lloji i Komentimit	Titulli / Ajeti / Sureja	Revista “Edukata Islame” (Viti/Numri)
26	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu el-Bekare (Kaptina II) – Ajetet 26–60	<i>Edukata Islame</i> , nr: 37-38, 1982, fq. 73-78.
27	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu el-Bekare (Kaptina II) – Ajetet 61–120	<i>Edukata Islame</i> , nr: 39, 1984, fq. 55-63.
28	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu el-Bekare (Kaptina II) – Ajetet 121–200	<i>Edukata Islame</i> , nr: 40, 1984, fq. 60-74.
29	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu el-Bekare (Kaptina II) – Ajetet 201–286	<i>Edukata Islame</i> , nr: 41-42, 1985, fq. 60-78.
30	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu Ali Imran (Kaptina III) – Ajetet 1–51	<i>Edukata Islame</i> , nr: 43, 1985, fq. 10-21.
31	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu Ali Imran (Kaptina III) – Ajetet 52–102	<i>Edukata Islame</i> , nr: 44-45, 1986, fq. 9-19.
32	Përkthimi i Kaptina-ve të Plota	Suratu Ali Imran (Kaptina III) – Ajetet 103–155	<i>Edukata Islame</i> , nr: 46-47, 1986, fq. 9-19.
33	Kaptinave të Plota	Suratu Ali Imran (Kaptina III) – Ajetet 156–200	<i>Edukata Islame</i> , nr: 48-49, 1987, fq. 13-22.

### Shtojcë: 1.

## Përfundim

Kur’ani famëlartë përbën një burim të thellë dhe të pashtershëm të udhëzimit dhe mëshirës hyjnore për njerëzimin, i cili kërkon përkthim dhe interpretim të kujdesshëm në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë edhe shqipen, për të mundësuar kuptimin e tij të plotë nga çdo besimtar dhe studiues. Tradita e përkthimit dhe tefsirit në gjuhën shqipe është dëshmi e përkushtimit të dijetarëve shqiptarë ndaj pasurimit të trashëgimisë islame dhe zhvillimit të mendimit fetar në një kontekst kombëtar dhe kulturor.

Në këtë kontekst, revista “Edukata Islame” ka luajtur një rol kyç si platforma e parë periodike shkencore dhe fetare në gjuhën shqipe në Kosovë, duke kontribuar në institucionalizimin e studimeve kuranore dhe promovimin e mendimit islam në hapësirën shqiptare. Përmes rubrikës së saj të tefsirit dhe botimeve të shumta, ajo ka ndihmuar në thellimin e kuptimit dhe interpretimit të Kur’anit, duke e lidhur atë me realitetin shoqëror, kulturor dhe shpirtëror të besimtarëve.

Megjithëse revista ka pasur disa mangësi në aspektin formal dhe teknik të publikimeve, ajo mbetet një shembull i rëndësishëm i përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve akademike dhe përforcimin e vetëdijes kulturore dhe fetare në një periudhë të vështirë historike. Ky punim evidenton rëndësinë e vazhdimësisë së traditës së interpretimit dhe përkthimit të Kur'anit në shqip, si dhe nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të platformave akademike që do të mundësojnë një dialog të pasur dhe të thelluar midis dijes klasike dhe sfidave bashkëkohore.

Në dritën e analizave të mësipërme, studimi i botimeve dhe interpretimeve të Kur'anit në “Edukata Islame” ofron një pasqyrë të vlefshme të historisë dhe zhvillimit të mendimit islam në hapësirën shqiptare, duke nënvizuar rolin e rëndësishëm që kanë luajtur intelektualët vendorë në përhapjen dhe thellimin e njohurive fetare dhe shkencore në gjuhën amtare.

## LITERATURA

- Ahmeti, Sherif. 1985. “Komentimi i Sures Zilzal.” *Edukata Islame*, nr. 15-16.
- Ahmeti, Sherif. 1985. “Komentimi i Sures Kevther.” *Edukata Islame*, nr. 41-42.
- Bajgora, Sabri. 2016. Kontributi i haxhi Sherifit në lëmin e Tefsirit dhe në përkthimin e Kur'anit, Prishtinë.
- Edukata Islame*. 1971. nr. I/1.
- Edukata Islame*. 1981. nr. X/30.
- Ibrahimi, Nexhat. 2003. *Dimensione Kur'anore*, Shkup: Logos- A.
- Islami, Sadat. 2002. “Përkthime në revistën Edukata Islame.” *Edukata Islame*, nr. 127-128.
- Kadriu, Liridon. *Historia e Përkthimit të Disa Pjesëve të Kur'anit në Gjuhën Shqipe*, Prishtinë.
- Krasniqi Batatina, Valmire. 2003. “Kosova'da Tefsir Alanında Yapılan Çalışmalar Üzerine Genel Bir Bakış.” *Rumeli İslam Araştırmaları Dergisi*, nr. 11. Trakya Üniversitesi.
- Mehdiu, Feti. “Dy Jubile Të Kulturës Islame Në Kosovë”, *Edukata Islame*.
- Shabani, Fation. 2015. “Kosova'da Yayınlanan İslami Bilimsel-Akademik Dergilerin İçeriği ve Kriğiği.” *Balkan Araştırmaları Dergisi*, nr. 2. Bursa: Emin Yayınları.
- Shkodra, Ramadan. 2017. *Bibliografi e Revistës “Edukata Islame (1971-2016)*, Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.
- Shkodra, Ramadan, dhe Aziz Pireva. 1998. “Historiku i publicistikës islame në gjuhën shqipe në Kosovë”, *Dituria Islame*, nr. 101.

## Shtojcë:

